



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 90/3 Prot.

Tiranë, më 12.04.2017

V E N D I M

Nr. 82, datë 12/04/2017

“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.123, datë 15.11.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 599 prot., datë 29.09.2016”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 123, datë 15.11.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 599 prot., datë 29.09.2016”, në institucionin e Bashkisë Klos,

VËREJ SE:

Me Urdhrin nr. 599, datë 29.09.2016, “Për verifikimin e ligjshmërisë së procesit të rekrutimit në shërbimin civil në Bashkinë Klos”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar inspektimi në lidhje me ligjshmërinë e rekrutimeve në Bashkinë Klos. Bazuar në këtë urdhër ka vijuar inspektimi në institucionin e mësipërm. Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr.123, datë 15.11.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.599., prot, datë 29.09.2016”, në të cilin është vendosur:

1. Fillimisht, njësia përgjegjëse duhet të përcaktojë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, duke u bazuar në faktin se ato ushtrojnë funksione publike, si dhe duke analizuar funksionet dhe detyrat konkrete të vendeve të punës përkatëse të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës. Këto përcaktime, duke përjashtuar rastet e parashikuara në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013

“Për nëpunësin civil” i ndryshuar, duhet t’i specifikojë në mënyrë të shprehur edhe në strukturën e institucionit.

2. *Njësia përgjegjëse, duhet të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, dhe të nxjerrë aktin e deklarimit të punësimit në shërbim civil për punonjësit, që rezultojnë se i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*
3. *Pas përfundimit të procesit të deklarimit të statusit të punësimit, njësia përgjegjëse për plotësimin e 19 (nëntëmbëdhjetë) pozicioneve të punës, duhet të ndjekë këtë rend veprimesh:*

Së pari, njësia përgjegjëse, duhet të drejtojë procesin e anulimit të akteve administrative që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për emërimin e përkohshëm për punonjësit, si më poshtë:

- *Aktin nr. 3, datë 12.02.2015, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në pozicionin, “Inspektor Mjedisi dhe Shërbimesh”.*
- *Aktin nr. 2, datë 12.01.2015, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** në pozicionin, “Inspektor i Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës”.*
- *Aktin nr.21, datë 02.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në pozicionin, “Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës”.*
- *Aktin nr.27, datë 13.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në pozicionin, “Inspektor i Arsimit, Kulturës, Rinisë e Sportit”.*
- *Aktin nr.26, datë 13.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** në pozicionin, “Inspektor i Barazisë Gjinore”.*
- *Aktin nr.29, datë 15.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në pozicionin, “Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Territorit”.*
- *Aktin nr.35, datë 23.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në pozicionin, “Inspektor Shërbimesh dhe Kontroll Territori”.*
- *Aktin nr.36, datë 28.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në pozicionin, “Specialist Jurist”.*
- *Aktin nr.39/1, datë 14.07.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** në pozicionin, “Inspektor i Shërbimeve”.*
- *Aktin nr.39, datë 07.07.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** në pozicionin, “Inspektor Finance”.*

- Aktin nr.37, datë 01.07.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit *****, në pozicionin, “Specialist i Ndihmës Ekonomike”.
- Aktin nr.45, datë 28.07.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit *****, në pozicionin, “Inspektor Mjedisi dhe Shërbimesh”.
- Aktin nr.59, datë 01.09.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit *****, në pozicionin, “Përgjegjës i Arsimit, Kulturës, Rinisë e Sportit”.
- Aktin nr.56, datë 01.09.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit *****, në pozicionin, “Inspektor i Arsimit, Kulturës, Rinisë e Sportit”.
- Aktin nr.57, datë 01.09.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit *****, në pozicionin, “Përgjegjës i Emergjencave Civile”.
- Kontratën e punës, datë 16.10.2015, për punonjësin *****, emëruar në detyrë në pozicionin “Audit i Brendshëm”, në të cilin është specifikuar edhe data e fillimit të marrëdhënieve financiare.
- Kontratën e punës, datë 16.10.2015, për punonjësin *****, emëruar në detyrë në pozicionin “Inspektor Shërbimesh”, në të cilin është specifikuar edhe data e fillimit të marrëdhënieve financiare.
- Kontratën e punës, datë 16.10.2015, për punonjësin *****, emëruar në detyrë në pozicionin “IT”, në të cilin është specifikuar edhe data e fillimit të marrëdhënieve financiare.
- Kontratën e punës, datë 16.10.2015, për punonjësin *****, emëruar në detyrë në pozicionin “Inspektor Shërbimesh dhe Kontroll Territori”, në të cilin është specifikuar edhe data e fillimit të marrëdhënieve financiare.

Së dyti, të verifikojë nëse ndonjë prej punonjësve që e gëzojnë statusin e nëpunësit civil nga **4** (katër) ish-Komunat apo Bashkia, i plotëson kërkesat për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira. Nëse rezulton ndonjë rast i tillë, të kryejë emërimin e tij pa konkurrim në atë pozicion.

Së treti, të verifikojë listën e punonjësve të dalë në lirim nga shërbimi civil, pas ristrukturimit të institucionit dhe nëse ndonjë prej tyre plotëson kërkesat e vendit të punës, për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira, të emërohet në atë pozicion, pa konkurrim.

Së katërti, pasi të ketë ezauruar tre hapat e parë, të shpallen procedurat e konkurrimit për pozicionet që do të rezultojnë ende të lira.

4. Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2016, planin e punës së pranimeve në shërbim civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

5. *Njësia përgjegjëse, të plotësojë pozicionet e punës që mbeten të lira, me anën e procedurave të konkurrimit të hapur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, si procedura që përfaqësojnë sistemin e karrierës në shërbimin civil, pasi të jetë respektuar rendi i veprimeve të përcaktuara më sipër.*
6. *Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të respektojë rregullat e përcaktuara në Kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.*
7. *Në veçanti, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:*
 - ✓ *Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimit dhe vlerësimit (Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (përveç lëvizjes paralele) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.*
 - ✓ *Të bëjë publik në faqen zyrtare, “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Klos, ose nëse është e mundur, në standat për publikun, shpalljet që kërkohen nga ligji dhe aktet nënligjore, për të materializuar procedurat e rekrutimit, të tilla si:*
 - ✓ *Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (arsimi i lartë përkatës); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjorë që duhet të përmbajë shpallja.*
 - ✓ *Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranimi në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.*

- ✓ *Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (lista përfundimtare) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.*
 - ✓ *Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.*
8. *Njësia përgjegjëse e Bashkisë Klos të zbatojë vendimin brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, që materializojnë veprimet administrative që janë kryer për zbatimin e këtij vendimi.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar nr. 123, datë 15.11.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Bashkisë Klos, prej datës 07.10.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, me Vendimin nr. 15, datë 09.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 123, datë 15.11.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni i Bashkisë Klos, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 07.10.2016 e në vazhdim”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 123, datë 15.11.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.599., prot, datë 29.09.2016”.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Klos dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 90/2 prot., datë 09.02.2017 “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Bazuar në procesverbalin e datës 23.02.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit, nënshkruar edhe nga personat e kontaktit të institucionit të Bashkisë Klos, dhe pas shqyrtimit të materialeve shkresore të administruara në përfundim të procesit të verifikimit, rezultoi sa më poshtë vijon:

- Në momentin e verifikimit në subjekt nuk ishte miratuar ende struktura organizative e Bashkisë Klos për vitin 2017. Megjithatë, nga ana e njësisë përgjegjëse u pretendua se me miratimin e kësaj strukture do të përcaktohen edhe pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në bashki dhe njësitë e saj administrative, në përputhje me rekomandimin e pikës 1 të vendimit të Komisionerit.
- Sikundër është evidentuar edhe në procesverbalin e mbajtur nga grupi i punës gjatë verifikimit në subjekt, njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 2 të vendimit, ka përfunduar procesin e deklarimit të statusit të punësimit në përputhje me nenin 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Njësia përgjegjëse, në zbatim të rekomandimit të pikës 3 të vendimit të Komisionerit ka bërë anulimin e akteve administrative që kanë dalë në kundërshtim me nenin 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar për punonjësit e mëposhtëm:

1. Vendimi nr.3, datë 26.01.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjës të ***** me detyrë specialist i Teknologjisë së Informacionit.
2. Vendimi nr.4, datë 26.01.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjës të ***** me detyrë Inspektor i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Vendimi nr.5, datë 26.01.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjës të ***** me detyrë Inspektor i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
4. Vendimi nr.79, datë 01.12.2016, “Për revokimin e aktit të emërimit” për punonjës të ***** me detyrë Inspektor Mjedisi dhe Shërbimesh.
5. Vendimi nr.75, datë 04.11.2016, “Për revokimin e aktit të emërimit” për punonjës të ***** me detyrë Audit i Brendshëm.

Punonjësit e tjerë (14 punonjës) të përmendur në pikën 3 të rekomandimit të Komisionerit vazhdonin marrëdhënien e punës me institucionin, ndërsa pozicionet e mësipërme të punës njësia përgjegjëse i ka shpallur të lira në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Me Urdhrin nr.13, datë 26.01.2017, janë shpallur 5 pozicione pune “specialist”, të cilat janë në fazën e vazhimit të procedurës së konkurrimit. Me njoftimin nr.2020, datë 27.10.2016, Bashkia Klos ka shpallur edhe tre pozicione pune “Drejtor”, nga të cilat ka përfunduar konkurrimi vetëm për pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit të Territorit dhe Shërbimeve” dhe ka dalë akti i emërimit për punonjës të Gëzim Ceni. Mbeten të papërfunduara konkurrimet për 2 (dy) pozicione pune “drejtor”, procedura të cilat janë në vazhdim. Ndërsa 6 (gjashtë) pozicionet e punës “specialist” në momentin e verifikimit të vendimit të Komisionerit ishin të pashpallura me pretendimin objektiv se koha për ekzekutimin e vendimit të Komisionerit ishte shumë e shkurtër.

Po kështu, njësia përgjegjëse, pasi ka verifikuar dosjet e punonjësve që kanë punuar në 4 (katër) ish-komunat e Bashkisë Klos ka konstatuar se dy prej tyre plotësonin kriteret e kërkuara nga ligji për shërbimin civil dhe i ka emëruar ata pa konkurrim si nëpunës civil në po ato pozicione pune që kanë pasur. Konkretisht, i është bërë deklarimi i statusit të punësimit nr.206, datë 27.08.2015, punonjës të ***** në pozicionin “Inspektor Pyjesh” në Njësinë administrative Suç dhe i është bërë deklarimi i statusit të punësimit nr. 205, datë 27.08.2015, punonjës të ***** në pozicionin “Inspektore Finance” në Njësinë Administrative Xibër.

- ✓ Në lidhje me rekomandimin e pikës 4 dhe 5, njësia përgjegjëse e Bashkisë Klos, në datë 17.10.2016 ka hartuar planin e pranimeve në shërbimin civil për pozicionet që rezultojnë të lira dhe, në vijim, me Urdhrin nr.125, datë 18.10.2016, janë shpallur të lira 3 pozicione pune “Drejtor” dhe me Urdhrin nr.13, datë 26.01.2016, janë shpallur 5 pozicione pune “specialist” që janë në fazën e vazhimit të procedurës së konkurrimit sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sikundër është shpjeguar edhe më sipër.
- ✓ Grupi i punës gjatë verifikimit të procedurës së konkurrimit të zhvilluar për pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit të Territorit dhe Shërbimeve” (procedurë e

përfunduar plotësisht), arriti në përfundimin se nga ana e njësisë përgjegjëse janë zbatuar përcaktimet e nenit 22 dhe 25 e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike, në përputhje me rekomandimin e Komisionerit në pikën 6 të vendimit.

- ✓ Sikundër është pasqyruar edhe në procesverbalin e mbajtur në këtë rast midis grupit të punës dhe përfaqësuesve të institucionit, në zbatim të pikës 7 të vendimit të Komisionerit, me Urdhrin nr.138, datë 18.11.2016, është krijuar “Komiteti i Pranimit për ngritjen në detyrë” dhe me Urdhrin nr.9, datë 18.01.2017 është krijuar “Komiteti i përhershëm i pranimit në kategorinë ekzekutive”. Nga verifikimet e kryera, rezulton se janë bërë publike në faqen zyrtare, “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” shpalljet që kërkohen nga ligji dhe aktet nënligjore për procedurat e rekrutimit, vërtetuar kjo nga praktika e plotë e konkurrimit për pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit të Territorit dhe Shërbimeve”, e cila është administruar si provë shkresore nga grupi i punës.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 123, datë 15.11.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 599 prot., datë 29.09.2016”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Klos janë zbatuar një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të lëna në vendimin paralajmërues.

Sa i takon rekomandimeve për përcaktimin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të nenit 19 dhe 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në strukturën që pritet të miratohet për vitin 2017 dhe anulimin e akteve të përkohshme të emërimit për 14 punonjës, duke vijuar me procedurat e konkurrimit për pozicionet e punës të zëna me emërim të përkohshme në kundërshtim me ligjin, të materializuara respektivisht në pikat 1 dhe 3 të vendimit, në kushtet kur nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit është pretenduar se koha e lënë në dispozicion për zbatimin e plotë të vendimit nuk ka qenë e mjaftueshme dhe është shprehur angazhimi për përmbushjen e tyre, në përputhje me rekomandimet e Komisionerit, këto pika të vendimit do të jenë objekt i verifikimit të mëtejshëm nga ana e Komisionerit.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenin 34 të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

- 1.** Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Klos, duke zbatuar rekomandimet e lëna në pikat 2, 4, 5, 6 dhe 7 të Vendimit nr. 123, datë 15.11.2016, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 599 prot., datë 29.09.2016”*.
- 2.** Verifikimin e mëtejshëm të zbatimit të rekomandimeve të pikës 1 dhe 3 të Vendimit nr. 123, datë 15.11.2016, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 599 prot., datë 29.09.2016”*.
- 3.** Njësia përgjegjëse dhe Kryetari i Bashkisë Klos duhet të zbatojnë rekomandimet e pikës 1 dhe 3 të Vendimit nr. 123, datë 15.11.2016, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 599 prot., datë 29.09.2016”* brenda një afati prej **30** ditësh nga marrja dijani për këtë vendim.
- 4.** Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Klos, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA